



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 155, datë 18.05.2021

**PËR MIRATIMIN E RENDITJES SË KANDIDATËVE PËR POZICIONIN  
VAKANT TË DREJTUESIT NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË  
APELIT TIRANË**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 47 pika 6 dhe 52 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 27 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” miratuar me Vendimin nr.200, datë 23.09.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Relatori dhe Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

- I. Miratimin e renditjes së kandidatëve për pozicionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë si më poshtë;
  1. **Genti Xholi**
- II. Vendimit i bashkëngjitet relacioni shpjegues i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.
- III. Të njoftojë kandidatin për këtë Vendim.
- IV. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e njoftimit të Vendimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**KRYETAR  
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA**



ANËTAR  
KOSTAQ BELURI




ANËTAR  
BUJAR SHESHI



ANËTAR  
NURIHAN SEITI



ANËTAR  
ELOIDA GOXHI



ANËTAR  
ESMERALDA KESHI



ANËTAR  
MOISI DUDA



ANËTAR  
VATË STAKA



ANËTAR  
SANDËR BECI



ANËTAR  
TARTAR BAZAJ

